



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Praktika Profesionale

Ngarkesa: Kredite 4 kredite dhe Orë: 80 orë mësimore; 0 leksione / 80 seminare
Viti / Semestri: Viti II, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Master i shkencave në “Komunikim Ndërkulturor dhe turistik trigjuhësh”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Programi i praktikës mesimore ka qëllim të pajisë studentët me: zgjerim të njohurive mbi çështje kulturore, historike, ekonomike dhe shoqërore të zonave gjeografike që lidhen me gjuhët e përzgjedhura, dhe të disiplinave bazë të shkencave shoqërore, ekonomike dhe juridike. Zgjerim të njohurive mbi rolin emediatorit ndërkulturor në institucione që përfshijnë fushën e marrëdhënieve kulturore midis vendeve dhe popujve; zgjerim të njohurive mbi rolin e mediatorit ndërkulturor në organizma dhe organizata ndërkombëtare, shoqatatë huaja dhe vendase si operator dhe kurator i marrëdhënieve ndërkombëtare,

Objektivat specifike lëndore:

1. Kompetenca gjuhësore: aftësia për të komunikuar me gojë dhe me shkrim si dhe njohja e terminologjisë bazë të komunikimit turistik dhe kulturor.
2. Kompetenca dixhitale: Aftësia për të kërkuar dhe administruar dhe referuar informacionin në internet.
3. Kompetenca shoqërore dhe qytetare: nxitja e punës në grup dhe sensibilizimi për temat sociale. Kompromisi me etikën si dhe me përgjegjësinë qytetare e profesionale.

Rezultatet e pritshme:

1. Studenti demonstroi njohuri të zgjeruara mbi kontekste kulturore, historike, ekonomike dhe shoqërore që lidhen me zonat gjeografike të gjuhëve të studiuara, si dhe mbi rolin e ndërmjetësit ndërkulturor në institucione dhe organizata ndërkombëtare.
2. Studenti është në gjendje të komunikojë në mënyrë të qartë dhe të saktë në një gjuhë të huaj për çështje të natyrës kulturore dhe turistike, duke përdorur terminologjinë përkatëse dhe mjetet dixhitale për kërkim dhe referencë.
3. Studenti bashkëpunon në mënyrë efektive në mjedise të ndryshme pune, tregon ndjeshmëri për temat sociale dhe kulturore dhe vepron me përgjegjësi profesionale e qytetare, duke respektuar parimet etike të fushës.